

Strategji Për Zhvillimin E Veprimtarisë Radiodifuzive



Shkup, 15.05.2017. – Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale sot shënoi edhe fillimin zyrtar të përgatitjes së Strategjisë për zhvillimin e veprimtarisë audio dhe audiovizuale nga viti 2018 e deri më vitin 2022.

Qëllimi i Strategjisë është të shënohen gjendjet vijuese në të cilën gjendet veprimtaria audio dhe audiovizuale në mënyrë që të përcaktohen qëllime dhe drejtime për zhvillimin e këtyre veprimtarive në pesë vitet e ardhshme, si dhe aktivitete konkrete për realizimin e këtyre qëllimeve. Strategjia është paraparë në Programin e punës së Agjencisë për vitin 2017 dhe e njëjta është që të planifikohet rezultati për procesin e gjerë konsultues me të gjithë faktorët nga veprimtaria me qëllim që e njëjta të përfshihet edhe në mënyrë adekuate të adresohen të gjitha çështjet kyçe të palëve të interesuara nga sfera mediatike.

Në strategji do të përcaktohen edhe aktivitete të caktuara me të cilat Agjencia do të pozicionojë qartë rolin e vetë si rregullator në nxitjen e zhvillimit të veprimtarisë, kurse propozimet dhe aktivitetet adekuate përmes së cilëve do të realizohen disa aspekte në sferën e medimeve, do të jepen nga

faktorët kryesor të industrisë dhe subjektet që i nënshtrohen rregullimit.

Kontribut për Strategjinë nga aspekt i përvojave dhe rezultateve të punës, Agjencia pret edhe nga institucionet, përmes kompetencave të vera, si dhe organizatave civile, përmes projekteve të shumta të medimeve ku Agjencia ka dhënë përkrahjen e vet të plotë.

Agjencia konsideron se Strategjia për zhvillimin e veprimtarisë audio dhe audiovizuele 2018-2022 duhet të orientohen ndaj gjashtë fushave të prezantuara në këtë [link](#), kurse propozimet lidhur me Strategjinë mund të dorëzohen deri në fund të muajit maj 2017 në këtë adresë elektronike strategjia2022@avmu.mk

[Propozim-Strategjia për zhvillimin e veprimtarisë radiodifuzive në R.M. \(2013-2017\) me planin aksionar](#)

[Stratgjia për zhvillimin e veprimtarisë radiodifuzive në R.M. \(2007-2012\)](#)